

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor[1]	Data e kërkesës[2]	Objekti i kërkesës[3]	Data e përgjigjes[4]	Përgjigje[5]	Mënyra e përfundimit të kërkesës[6]	Tarifa[7]
1	12.02.2021	Informacion në lidhje me trajnimet që kryhen nga ASPA, konkretisht shprehje interesi në lidhje me certifikimet për trajnimet që stafi bën. Pyetje nëse ka mënyrë për të konfirmuar pjesëmarrjen dhe trajnimin që mund të kryejnë në mënyrë që të pasurohet dosja e nëpunësit.	13.02.2021	Për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19 trajnimet për nëpunësit civil po vazhdojnë të zhvillohen online. ASPA ofron një gamë të gjërë trajnimesh në të gjitha fushat, për të cilat ju mund të informoheni periodikisht nëpërmjet kalendarit të trajnimeve të ASPA. Kalendarit të trajnimeve publikohet në rrjetet tona: Link i web ASPA: http://aspa.gov.al/ Link i FB ASPA: https://www.facebook.com/ShkollaeAdministratesPublike/ Nëpunësit mund të regjistrohen vetë sipas link-ve të publikuara për çdo temë trajnimi që ata kanë interes. Në përfundim të çdo webinarit nëpunësit i vërtetohet pjesëmarrja nëpërmjet email konfirmues, kurse në rastet e ndjekjes së kurseve online pajisen me certifikatën përkatëse.	E Plotë	Nuk ka tarifë
2	17.02.2021	Kërkesë për informacion mbi kriteret të cilat duhet të plotësohen për ndjekjen e kurseve online me certifikim.	27.02.2021	Faleminderit për interesimin. Kriteret për të aplikuar në kursin online janë ngarkimi i dokumentit që provon pajisjen e statusit (akt emërimi ose vërtetim), gjithashtu mund të ngarkohet akti i emërimit në periudhë prove dhe konfirmimin e eprorit (emailin e konfirmimit ose shkresë nga eprori). Këto dokumente duhen ngarkuar të dyja në aplikimin në website.	E Plotë	Nuk ka tarifë
3	25.04.2021	Kërkesë për informacion në lidhje me programin e internship	26.04.2021	Periudha e internshipit është koha kur studentët dhe të sapo-diplomuarit fillojnë të zhvillojnë shprehitë praktike, njohuritë për marrëdhëniet e punës, përjetojnë nga afër përvojën profesionale, krijojnë njohjet dhe rrjetin e parë zyrtar, i shtojnë pikë CV-së dhe mësojnë si menaxhohet realisht koha në vendin e punës. Për shumë të rinj internshipi shënon karrierën e tyre, si dhe formëzon tipin e punonjësit që do të jenë në të ardhmen. ASPA ju vjen në ndihmë të rinjve për të gjithë këta elementë. Programi ynë i internshipit ofron mundësi të vërteta për përfshirjen tuaj në proceset tona të punës, për pjesëmarrje në programet tona të trajnimit, si dhe për këshillim për karrierën tuaj në administratë publike dhe jo vetëm. Programi i internshipit në ASPA ka një kohëzgjatje prej të paktën 6 muaj, ku është e nevojshme dhe paraqitja në ambientet e shkollës gjatë kësaj periudhe. Internship është pa pagese dhe në fund të tij ju do të keni mundësi të merrni një vërtetim për periudhën e ndjekur.	E Plotë	Nuk ka tarifë
4	07.05.2021	Kërkesë për të aplikuar në lidhje me vende vakante në disiplinat e shkencave kompjuterike	16.05.2021	Ne vijim të kërkesës bëjmë me dije se ASPA është institucion shtetëror dhe punonjësit e saj janë me status të nëpunësit civil. Rekrutimi bëhet në bazë të ligjit për nëpunësit civil. Por, ASPA edhe ofron programin e internship për studentë të interesuar për një periudhë të paktën prej 6 muaj, ku mund të aplikohet duke dërguar një CV dhe letër motivimi.	E Plotë	Nuk ka tarifë
5	17.07.2021	Kërkesë për trajnimet që ofron ASPA referuar fushës së mjedisit, mbetjeve dhe të drejtave të konsumatoreve për punonjësit të cilët nuk e gëzojnë statusin e nëpunësit civil.	26.07.2021	Shërbimet e ASPA në bazë të parashikimeve ligjore, ofrohen pa pagesë për punonjësit që kanë statusin e nëpunësit civil, si dhe për ato në periudhë prove, ndërsa për pjesëmarrësit e tjerë ofrohen kundrejt pagesë përkatëse ligjore. ASPA po punon që të mundësojë pjesëmarrjen e të gjithë të interesuarëve duke mundësuar tarifa ligjore të arsyeshme, të cilat mund të paguheshin edhe nga vetë institucioni për punonjësit, përveçse nga vetë personat që kanë interes të ndjekin trajnimin. Dëshira jonë është të ofrojmë trajnim për të gjithë, por kjo procedurë ka një serë hapash që të bëhet operacionale, prandaj lutemi të kemi mirëkuptimin tuaj.	E Plotë	Nuk ka tarifë
6	26.07.2021	Interes për trajnimet "Konflikti, Negocimi, Vendimarrja" dhe "Rregullimi i marrëdhënies juridike të shërbimit civil". Informacion nëse këto trajnime shoqërohen me certifikatë nga ASPA.	26.07.2021	Në përfundim të ndjekjes me sukses të dy kurseve që ju keni shprehur interes, ju bëjmë me dije se shoqërohen me certifikatë pjesëmarrje. Për të aplikuar, ju lutem të klikoni në linkun që gjendet më poshtë dhe aty do të gjeni dy modulet të vendosura si më poshtë: Afati i aplikimit 8 Gusht "Konflikti, negociimi dhe vendimarrja" Kurs Online, Prof. Asoc. Dr. Roland Lami, Dt. 13 Shtator – 27 Shtator 2021 Afati i aplikimit 15 Gusht "Rregullimi i marrëdhënies juridike të shërbimit civil" Kurs Online, Kejsi Rizo, Dt. 13 Shtator-29 Shtator 2021 Link i aplikimit: https://aspa.gov.al/aplikimi/	E Plotë	Nuk ka tarifë
7	07.07.2021	Informacion për rrugën e aplikimit si trajner pranë ASPA	07.07.2021	Për të aplikuar në pozicionin e trajnerit, lutem të dërgoni CV dhe letër motivimi në adresën zyrtare aspa@aspa.gov.al në momentin që ASPA hap thirrjet për trajnerë. Më poshtë do të gjeni linkun e ndërfaqes në website e cila përdësohet me thirrjet e reja për trajnerë: https://aspa.gov.al/thirrje-per-eksperte-aspa/	E Plotë	Nuk ka tarifë

8	04.09.2021	Kërkesë për informacion më të detajuar për të ndjekur shkollën	07.09.2021	<p>Lutem gjeni në vijim një informacion të shkurtër rreth ofertave tona.</p> <p>ASPA ofron aktualisht:</p> <p>-Kurse online me certifikim të cilat kanë kohëzgjatje të ndryshme dhe zhvillohen online me klasa të mbyllura me një numër të kufizuar pjesëmarrësish. Këto kurse janë të strukturuar dhe përveç sesioneve live online, ofrojnë dhe mundësi të coaching individual me trajnerin si dhe për të mundësuar vlerësimin ka detyra, projekte, prezantime ose testim që realizohen përpara certifikimit. Për të qenë pjesë e kurseve online ju duhet të aplikoni në website e ASPA, në momentin që këto aplikime do të jenë të hapura, duke plotësuar të dhënat tuaja dhe duke ngarkuar dokumentet e nevojshme. Në përfundim të ndjekjes me sukses të kursit dhe prezantimit të detyrave ju merrni certifikatën.</p> <p>-Webinare me një kohëzgjatje 1.5-2 orë të cilët trajtojnë tema specifike të fushave të ndryshme me interes për punonjësit e administratës publike. webinarët ju japin mundësi që të drejtoni pyetjet që ju keni, çështje për diskutim dhe të komunikoni drejtpërdrejtë me trajnerin. Në përfundim të ndjekjes së webinarëve të zhvilluara nga ASPA ju do të keni mundësinë e marrjes së një email-i nga adresa zyrtare e ASPA e cila konfirmon pjesëmarrjen tuaj. Webinarët janë pa certifikim.</p> <p>-Ligjëratë/Masterclass të cilat janë një bashkëpunim i ASPA me personalitetet më të njohura ndërkombëtare dhe kombëtare. Këto ligjëratë japin mundësi unike për të mësuar, por edhe diskutuar me mjeshtra të fushave të ndryshme.</p>	E Plotë	Nuk ka tarifë
9	17.09.2021	Në kuadër të Strategjisë së Edukimit Ligjor të Publikut, të zbatuar nëpërmjet Planit të Veprimit 2020-2023 të miratuar me VKM-në nr. 878, datë 11.11.2020, sjell në vëmendje objektivin nr. 3.2.1.a "Punonjës të institucioneve publike të trajnuar (njohuri të certifikuar) lidhur me zbatimin e ELP-së", ku Ministria e Financave dhe Ekonomisë është një nga institucionet përgjegjëse dhe ASPA është institucion kontribues. Në cilësinë e personit të kontaktit për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për Rrjetin e Edukimit Ligjor të Publikut, lutem pranimin e shprehjes sime të interesit për pjesëmarrjen në trajnimet që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.	20.9.2021	Dërguesi njoftohet për trajnimet në fushën e edukimit ligjor.	E Plotë	Nuk ka tarifë
10	17.09.2021	Kërkesë për informacion për zhvillimin e trajnimeve në ASPA online dhe në klasë	17.09.2021	Personi informohet se trajnimet që ASPA ofron online që prej situatës së krijuar nga pandemia.	E Plotë	Nuk ka tarifë
11	15.09.2021	Kërkesë për informacion pse shërbimet e ASPA ofrohen me pagesë	22.09.2021	Shërbimet e ASPA në bazë të parashikimeve ligjore, ofrohen pa pagesë për punonjësit që kanë statusin e nëpunësit civil, si dhe për ato në periudhë prove, ndërsa për pjesëmarrësit e tjerë ofrohen kundrejt pagesës përkatëse ligjore. Organizimi i ASPA rregullohet me Ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 138 datë 12/03/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe trajnimin e nëpunësve civilë".	E Plotë	Nuk ka tarifë
12	08.10.2021	Kërkesë për informacion për e-Leaning	15.10.2021	<p>Shkolla Shqiptare e Administratës Publike-ASPA sjell shërbimin më të ri e-Learning, nëpërmjet të cilit synon t'i vijë në ndihmë administratës publike dhe më gjerë në procesin e të nxënimit online dhe në mënyrë të pavarur.</p> <p>E-learning, vjen si risi në fushën e trajnimit e cila ndihmon të mësuarit interaktiv, në distancë dhe në çdo kohë pavarësisht nga oraret e punës duke shfrytëzuar teknologjinë. Ky shërbim do të jetë në dispozicion të përfutuesve nga administrata publike dhe më gjerë me synim zhvillimin profesional të tyre, në përballimin me sukses të objektivave të punës dhe realizimit të programit të qeverisë.</p> <p>Pranë shkollës tonë është ngritur me sukses një skuadër relativisht e vogël, por me vision dhe objektiva të qarta për përmbytjen e kërkesave për trajnim në këtë kategori, për punonjësit e administratës publike në vend dhe më gjerë.</p> <p>ASPA po punon fort për të zhvilluar dhe përforcuar gjithnjë e më shumë me inovacionet më të reja që mundëson teknologjia në raport me e-Learning për të qenë pranë një në plotësimin e nevojave për trajnim dhe zhvillim.</p> <p>Aktualisht ASPA shërbimet po i ofron online nëpërmjet platformave siç janë GoToMeeting, GoToWebinar dhe platformës Zoom. Gjithashtu, ofrohet dhe biblioteka e-library që aksesohet nga punonjësit e administratës publike. Trajnime online zhvillohen dhe në platformën LMS.</p>	E Plotë	Nuk ka tarifë
13	21.10.2021	Referuar shkresës nr. prot.1163, date 27.10.2021 " Së shpejti fillojmë ofrimin e shërbimit të trajnimit kundrejt tarifës", doja një informacion mbi trajnimet që ofroni për pozicionin Nëpunës informacioni dhe tarifa përkatëse.	26.10.2021	Shërbimet e ASPA në bazë të parashikimeve ligjore, ofrohen pa pagesë për punonjësit që kanë statusin e nëpunësit civil, si dhe për ato në periudhë prove, ndërsa për pjesëmarrësit e tjerë ofrohen kundrejt pagesës përkatëse ligjore. Shumë shpejt ASPA do të mundësojë ofrimin e shërbimeve me pagesë dhe do të gëndojë në kontakt me të interesuarit për të identifikuar nevojat përkatëse të institucionit apo punonjësit të interesuar.	E Plotë	Nuk ka tarifë

14	29.10.2021	Shprehje interesi për të ndjekur Shkollën e Trajnerëve pranë ASPA. Informacion për kriteret bazë si dhe çdo informacion ndihmues për të ndjekur këtë shkollë.	01.11.2021	Një nga shërbimet që do të ofrojë shkolla jonë është Shkolla e Trajnerëve, por aktualisht ne jemi duke punuar në ngritjen e këtij programi. Kërkesa juaj do të jetë në vëmendjen tonë dhe ju do të njoftoheni në vijim për të reja më të fundit.	E Plotë	Nuk ka tarifë
15	04.06.2021	Kërkoj nga ana jua që të më dërgoni informacion në lidhje me mënyrën sesi trajnohen nëpunësit civil nga ASPA. Çfarë procedurash ndiqen, cilat janë programet e trajnimit, pra çdo gjë në lidhje me trajnimin e nëpunësve. Ky informacion më nevojitet për çështje studimesh sepse po punoj me temën e diplomës mbi këtë çështje. Shpresoj shumë ta kem një informacion të tillë nga ju.	10.06.2021	Informohet mbi Ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 138 datë 12/03/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe trajnimin e nëpunësve civil" si dhe website e ASPA, ku ka informacione të plota për shërbimet e shkollës.	E Plotë	Nuk ka tarifë

* Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), është institucion publik qendror, me autonomi administrative dhe akademike, që ka për qëllim formimin e nëpunësve të pushtetit qendror, pushtetit vendor, si dhe institucioneve të pavaruara. **

ASPA gjatë vitit 2021 ka ofruar:

- Kurse online me certifikim me kohëzgjatje të ndryshme dhe zhvillohen online me klasa të mbyllura me një numër të kufizuar pjesëmarrësish dhe coaching individual me trajnerin;
- Trajnim në klasë
- Webinare për nëpunësit civil
- Webinare të hapura
- Trajnimin e detyrueshëm për nëpunësit në periudhë prove;
- Trajnim për Trupën e Nivelit të Lartë Drejtuese
- Workshop **Duke pasur qëllim në vetvete trajnimin e gjithë administratës dhe më gjerë, kërkesat që paraqiten pranë institucionit tonë janë të larmishme dhe kryesisht janë të përsëritura. Për këtë arsye në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve reflektohen disa shembuj kërkesash që vijnë në insitucionin tonë. Informacioni i pasqyruar në faqen tonë të website është i plotë dhe i qartë për çdo shërbim që ASPA ofron.

[1] Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

[2] Data e regjistrimit të kërkesës

[3] Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

[4] Data e kthimit të përgjigjes

[5] Përmbytja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

[6] Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

[7] Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.